

AKTI I THEMELIMIT
I
SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“Geops_Gym” Sh.p.k

Themeluesi qe nenshkruan me poshte si vijon:

1) Zj. Arsen Halit me ID H80521196W

Qe ne vijim do te quhen Ortaku i Shoqërisë “Geops_Gym” Sh.p.k.

Sot me date 05.01.2025, bazuar ne vullnetin e tij te lire dhe ne perputhje me ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregetare”, vendosi te themelojne Shoqerine Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar, ne baze te kushteve qe vijojne:

Kreu I

OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK

Neni 1

Objekti i shoqerise

Shoqeria “Geops_Gym” Sh.p.k, ka si objekt veprimtarie:
Palestër, Fitnes.

Neni 2

Emertimi dhe Selia Juridike e Shoqerise

1. Ortaku vendosi qe shoqerine t’e emertohej “Geops_Gym” Sh.p.k
2. Selia juridike e Shoqerise ndodhet ne adresen: Tiranë, Qendra Tregtare Kristal, njesia nr.5, me siperfaqe totale 3291.64 m2, me numer pasurie 6/380- N4, 1001, Kati pare 1000.
3. Shoqeria mund te krijojë qendra sekondare, dege, zyra perfaqesimi e agjensi ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.

Neni 3

Forma Juridike

1. Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi
2. Me vendim te Ortakut te vetem/Asamblese se Pergjitheshme mund te ndryshoje formen juridike te Shoqerise, ne qofte se ne te ardhmen krijohen premisa me te favorshme per funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Ne kete rast do te pershtatet Akti i Themelimit dhe Statuti e shoqerise, si dhe do te behet regjistrimi i saj ne rregjistrin tregtar, ne organet kompetente shqiptare.
3. Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar nga organet kompetente dhe ne perputhje me ligjin.
4. Shoqeria do te kete vulen e saj.

Kreu II

TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA

Neni 4

Te drejtat e Shoqerise dhe te Ortakut te vetem/Ortakeve

1. Shoqeria ka te drejte te lidhe marreveshje dhe te nenshkruaje kontrata ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj.
2. Shoqeria gezon te drejten te krijojte pasuri materiale dhe intelektuale.
3. Shoqeria ka te drejte te marre pjese si ortak ne nje shoqeri tjeter ose ndermarrje te ndryshme ne Shqiperi ose jashte saj, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.
4. Shoqeria pergjigjet ndaj te treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqeror te derdhur dhe me te mirat e pasurise se saj.
5. Ortaku i Vetem/Ortaket marrin pjese ne administrimin e veprimtarise se shoqerise ne perputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, vet ose nepermjet perfaqesuesve te tij.
6. Ortaku i Vetem/Ortaket kane te drejte te marrin te gjitha informatat qe kane te bejne me veprimtarine prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare te shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike etj.

Neni 5

Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqërisë është me afat të pacaktuar.

Kreu III

KAPITALI THEMELTAR

Neni 6

Kapitali Themeltar

1. Shoqëria tregtare “Geops_Gym” Sh.p.k ka një kapital themeltar në shumën 100(njëqind) Lekë.
2. Ortaku zotëron një kuotë në shoqëri.
3. Pjesëmarrja e Ortakut në kapitalin themeltar të shoqërisë është në përputhje me kontributin e mëposhtem:
 - Z. Arsen Halit, zotërues i një kuote, me vlerë të përgjithshme 100 (njëqind) Lekë, që përbën 100 % (njëqind për qind) të kapitalit të nënshkruar të shoqërisë;

Kreu IV

PERSONALITETI JURIDIK

Neni 7

Shoqëria fiton personalitetin juridik në ditën e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar në Qendren Kombëtare të Biznesit në Tiranë, si dhe fillon veprimtarinë e saj me marrjen e licencës të ushtrimit të veprimtarisë.

Kreu V

ADMINISTRIMI

Neni 8

1. Shoqëria do të administrohet nga administratori z. Arsen Halit për një periudhë 5 **(pesë)** vjetë dhe me të drejtë rizgjedhje.
2. Administratori mund t’i delegojë kompetencat e tij me shkrim në formën e autorizimit ose me prokurë.

Kreu VI
DISPOZITA TE TJERA

Neni 9

1. Fitimi i realizuar nga Shoqeria, pas shlyerjes se detyrimeve ligjore, do t'i mbetet Ortakut te saj .
2. Ky Akt shtypet dhe nenshkruhet ne 2 (dy) kopje, te gjitha me te njejten vlere ligjore.
3. Nje kopje qendron ne dokumentacionin baze te shoqerise.

ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE

Arsen Halit